



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	23.08.2024
REFERENC-Ë:	24/259/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Air Energy" Sh.p.k, Gjilan , Parku i Eenergjisë me Erë "Kitka 32.5 MW", Poliçkë, Hogoshtë dhe Velegllavë e Epërme. K.Kamenicë.
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "Air Energy" Sh.p.k, Gjilan, Parku i Eenergjisë me Erë "Kitka 32.4 MW", Poliçkë, Hogoshtë dhe Velegllavë e Epërme. K. Kamenicë, me nr. prot. 24/259/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

1.Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë "" Air Energy"Sh.p.k, Gjilan, Parku i Eenergjisë me Erë "Kitka 32.4 MW", Poliçkë, Hogoshtë dhe Velegllavë e Epërme. K. Kamenicë

Me respekt,

Faqe 1 nga 4





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*


Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/259/MMPHI
Datë: 23.08.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Kompania "Air Energy" Sh.p.k, Gjilan, **pajiset me Leje Mjedisore** për Parkun e Energjisë me Erë, "Kitka 32.5 MW", në ngastrat kadastrale, Poliçkë, Hogoshtë dhe Velegllavë Epërme. K. Kamenicë, sipas Lejes Ndërtimore nr. K.III-17/2018, të lëshuar me datë: 03.07.2018, për nëntë (9) turbinat me kapacitet të përgjithshëm 32.5 MW.



Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Të mirëmbahen fuqitë ku ruhen vajrat e përdorura, gjer sa të largohen nga kompania e Licensuar për Riciklim;
- Ti përmbahet planit të ri-kultivimit që është prezantuar në MMPHI;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të bëjë rehabilitimin e zonës se ndikuar.


A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore për kompaninë, "Air Energy" Sh.p.k, Gjilan, për Parkun e Energjisë me Erë, "Kitka 32.5 MW", në ngastrat kadastrale, Poliçkë, Hogoshtë dhe Velegllavë e Epërme. K. Kamenicë, sipas Lejes Ndërtimore nr.K.III-17/2018, të lëshuar me datë: 03.07.2018, për nëntë (9) turbinat me kapacitet të përgjithshëm 32.5 MW, komisioni konstaton se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit-ARBK;
- Pëlqim Mjedisor me Nr. 15/4081/1-ZSP-173/15 të lëshuar me dt. 22.09.2015;
- Leje Mjedisore me Nr. 18/5314/ZSP/01/19 date: 18.01.2019;
- Leje Ndërtimore nr.K.III-17/2018, të lëshuar me datë: 03.07.2018;
- Raportin e matjeve të zhurmës, nr.680, të lëshuar me datë; 29.10.2023;
- Kontrata e kompanisë së Licensuar me nr. prot.12/28/2020, për largimin e vajrave për riciklim;

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet administrative dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.



Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës Kamenicë
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPHI-së


Izedin Bytyqi
Sekretar i Përgjithshëm